



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.250/12 prot.

Datë 15.04.2025

V E N D I M
Nr. 506/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 274/2025, datë 24.02.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** BOE “Environmental Management Consultants” shpk me NIPT K81317002P dhe “ALPHA STUDIO SHPK me NIPT L91309043N dhe adresë Rruga Bedri Karapici, Kompleksi Tirana Golden Park, Hyrja e Biznesit, Kati i parë, Nr. 5, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tiranë me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 24.02.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 274/2025, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “*Environmental Management Consultants*” shpk & “*ALPHA STUDIO*” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomik “*Environmental Management Consultants*” shpk & “*ALPHA STUDIO*” shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.4056/5 prot., datë 14.04.2025, protokolluar me tonën nr. 250/9 prot., datë 15.04.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 274/2025, datë 24.02.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr.4056/5 prot., datë 14.04.2025, protokolluar me tonën nr. 250/9 prot., datë 15.04.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 274/2025, datë 24.02.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 4056/5 prot., date 14.04.2025 rezulton, se autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë informon se ka zbatuar vendimin Nr. 274/2025, datë 24.02.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e operatorëve ekonomik sipas vendimit nr. 274/2025, datë 24.02.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka pasqyruar vlerësimin në SPE.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. nr. 274/2025, datë 24.02.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-34359-12-23-2024 me objekt “Krijimi i hartës strategjike të zhurmave në Bashkinë e Tiranës” me fond limit 4,999,722.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 06-01-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri

